



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:203604

Datë: 02.04.2024

Numri i dokumentit: 05534842

KPPP.nr. 1518/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Agron Commerce” Sh.P.K., me numër unik identifikues 810364216 dhe me seli në Mitrovicë, Zona Industriale, p.n., kundër debitorit “Trepça” Sh.A., me numër të unik identifikues 811278747 dhe me seli në Mitrovicë, Parku Industrial, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 1109/2023 i datës 25.08.2023, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Atip Mustafa nga Mitrovica, jashtë seancës me datën 02.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit “Trepça” Sh.A., ndërsa Urdhri Përmbartimor P.nr. 1109/2023 i datës 25.08.2023, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Atip Mustafa, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Agron Commerce” Sh.P.K., me datë 25.08.2023 ka lëshuar urdhrin P.nr. 1109/2023, duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit Faturës nr. 18, e datës 12.04.2023, me të cilin e ka urdhëruar debitorin që brenda afatit prej 7 ditësh nga data e dorëzimit të urdhrin në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturës së lartcekur t’ia paguaj kreditorit shumën prej 40,611.40 EUR, me kamatë ligjore prej 8 %, nga data e kalimit të afatit për pagesë e deri në përmbushjen definitive të detyrimit, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Debitori, përmes përfaqësuesit të autorizuar brenda afatit ligjor ka parashtruar Prapësim duke kundërshtuar në tërësi Urdhrin Përmbartimor me arsyetim se dokumenti në bazë të së cilit është marrë urdhri përmbartues nuk është i përshtatshëm për përmbartim sepse në faturë nuk është cekur

koha e përmbushjes së detyrimit ashtu siç parashihet me nenin 27, par. 1 të LPP-së. I ka propozuar gjykatës që të anulojë urdhrin për përmbarim P.nr. 1109/23, të datës 25.08.2023.

Kreditori nuk ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Gjykata, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, dhe me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*.

Gjykata në rastin konkret vlerëson se Fatura nr. 18, e datës 12.04.2023, i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara në përputhje sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, koha e përmbushjes së këtij detyrimi, si dhe e njëjta i është bashkëngjitur propozimit për përmbarim në origjinal, në përputhje me nenin 37 të LPP-së.

Tutje Gjykata gjeti se fatura e lartcekur është pranuar në mënyrë të rregullt nga ana e debitorit, fakt ky që vërtetohet nga nënshkrimi i debitorit në faturë dhe vula e protokollit të debitorit, e për më tepër, faturës së lartcekur i është bashkëngjitur edhe fletëpranimi i mallit nr. 90/2023 i lëshuar nga vet debitori me rastin e pranimin të faturës, andaj rezulton se debitori, ka qenë në dijeni lidhur me detyrimin që buron nga fatura objekt i këtij përmbarimi, dhe të njëjtën asnjëherë nuk e ka kundërshtuar.

Gjykata pati parasysh pretendimet e ngritura nga debitori në prapësim, por gjeti i njëjti nuk ka ofruar asnjë provë siç kërkohet me neni 69 par.4 të LPP-së, për të vërtetuar ekzistimin e një prej

shkaqeve të parashikuara me nenin 71 të LPP-së mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 par të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1518/23, datë 02.04.2024

Gjyqtari

Florent Zeqiri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.